



| | | | |
|---|---------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|
| Pranuar / Donesor / Prisjepe / Poselato / Received / Dattorev | 09.06.2021 | 1 | 1 |
| Organ / Agjencia / Organ / Jedinstvo / Org / Agencija | No / Prot / No / Prot / Prot No | Shtypje / Printig / Approvato | Shtete / Kancelaria / Udaretori |
| SONSAR | 2888/2021 | | 117 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.377/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1649/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.562/2019 të datës 23.09.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr."Azem Jashanica" Nr.41; Dragodan, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.562/2019 e datës 23.09.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.2147 i datës 03.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe anulohet procedura e rekrutimit për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit" në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendimi.

A r s y e t i m

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 12.07.2019, me datë 12.07.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit". Në

këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë) por që nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm në këtë pozitë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 30.07.2019 ka publikuar njoftimin me numër Nr. 6510 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 28.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë më datë 03.09.2019 nxjerr Vendim me numër Nr.2117 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi shpalljen e publikimit të rezultateve.

Sekretari i Përgjithshëm me datë 02.09.2019 ka nxjerrë vendimin numër ref: 02/Nr.246 dhe numër prot:2141 me të cilin e ka transferuar ankuesen nga pozita "Zyrtare për Politika Turistike në Departamentit" në pozitën "Zyrtare e Arkivit" në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Ankuesja më datë 04.09.2019 nëpërmjet E-mailit të orës 08:06 minuta ka njoftuar Ushtruesin i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme se "Nga sot hyjë në pushim mjekësor".

Ndërsa Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme me datë 04.09.2019 në orën 08:53 minuta nëpërmjet E-mailit ankueses i ka shqiptuar masë disiplinore vërejtje me shkrim me arsyetim për mos respektim të orarit të punës për kohën " Ju sot me 04.09.2019 nuk jeni në vendin e punës në Arkivin e MTI-së".

Ankuesja me datë 19.09.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokoli:7848 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kundër vendimin numër ref: 02/Nr.246 dhe numër protokoli:2141 të datës 02.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm.

Ankuesja me datë 19.09.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokoli:7849 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kundër masës disiplinore vërejtje me shkrim të datës 04.09.2019 të shqiptuar nga Ushtruesi i Detyrës i Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 19.09.2019 ankueses i ka kthyer përgjigje përmes e-maili duke e njoftuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka kompetencë që të trajtojë ankesa pas datës 11.09.2019, ndërsa nëpunësi civil ka të drejtë që ankesën ta paraqesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës -KPMShCK.

Ankuesja kundër Vendimit me numër Nr.2117 të datës 03.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe kundër njoftimit të datës 19.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4453/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.09.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 15.10.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4453/2018 të datës 23.09.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr. 7309 të datës 03.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Ankesën e datës 28.08.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 19.09.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër prot:7848; Ankesën e datës 19.09.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër prot:7849; Emailin njoftues të datës 19.09.2019; Njoftimin e datës për kandidatin e suksesshëm të datës 10.05.2019; Konkursi i brendshëm datës 12.07.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 i ankueses i datës 31.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017 i ankueses i datës 22.12.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2016 i ankueses i datës 23.12.2016; Vendimin e datës 02.09.2019; Emaili 02.09.2019; kopjen e fotove të facebook; Njoftimin e kandidatit të suksesshëm i datës 26.12.2018; Emaili i datës 26.12.2019; Emaili i datës 30.07.2019; Vendimin e datës 25.06.2019; Njoftimi i datës 29.07.2019; Email i datës 04.09.2019 për njoftimin e shqiptimit të vërejtjes ndaj ankueses; Emaili i datës 04.09.2019 me njoftimin e drejtuar nga ankuesja për njoftimin e pushimit mjekësor; Raportet e konsultave mjekësore të datave 04.09.2019, 03.09.2019, 02.09.2019; Përgjigja në ankesë e datës 15.10.2019 me numër protokoll 4852/2019; Autorizimin nga DASHC/MAP i datës 12.07.2019; Vendimin e datës 24.07.2019 vendimin e datës 17.09.2019 vendimin e datës 25.06.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 20.07.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.05.2017; Akt emërimi i datës 01.09.2014 me përshkrimin e detyrave të punës; vendimi i datës 13.07.2018; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; kërkesa për punësim e kandidatës së përzgjedhur e datës 18.07.2019; Gjendja e Llogarisë së trustit për kandidaten e përzgjedhur; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 17.05.2017; Vërtetim pune e datës 16.10.2016; Kopja e letërnjoftimit të kandidatës së përzgjedhur; Letër reference i datës 01.12.2016; Diplomën e datës 28.02.2017 me Nr.195/2017; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 15.11.2017; Akt emërimi i datës 17.06.2019; Kërkesa për punësim e ankueses e datës 19.07.2019; Diploma e datës 02.10.2004 me Nr.585; Diploma e datës 08.05.2018 me Nr.29/2018; vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 18.07.2019; vendimi i datës 24.09.2019; Vendimi i datës 21.06.2019; vendimin e datës 21.12.2017; vendimin e datës 06.06.2016; Vendimi i datës 14.03.2017; Vendimin e datës 20.07.2015; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 07.10.2014; vërtetim për kryerjen të kursit intensiv e datës 30.04.2003; Çertifikatë e datës 18.08.2017; Vendim i datës 03.07.2019; Çertifikatë e datës 23.10.2014; Mirënjohje e datës dhjetor 2017; letër reference e datës 01.11.2007; Çertifikatë e datës 06.04.2012; Çertifikatë e datës 04.05.2012; Çertifikatë e datës 18.05.2012; letër reference e datës 29.06.2007; vendim nr.228 i datës 17.08.2018; vendim i datës 17.08.2018; Vendimi i datës 03.02.2015; vendim i datës 08.08.2016; vendimi i datës 25.05.2018; vendim i datës 22.12.2016; vendim i datës 15.05.2017; vendimin e datës 27.08.2007; vendimi për transfer të përhershëm të nëpunës i datës 05.09.2014; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 05.01.2007; Kontratë e punës e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës ; Vërtetim i datës 28.08.2006; Vërtetim pune i datës 05.01.2009; m, Kopja e lejes së vozitjes së ankueses; Kërkesa për punësim e kandidatës Kërkesa për punësim e kandidatës Kërkesa për punësim e kandidatës Diploma e datës 01.11.2016 me Nr.7303; Kërkesa për punësim e kandidatit Testi me shkrim i kandidatës së përzgjedhur; Testi me shkrim i ankueses; Formularët Form.MAP-SHCK-08a

për vlerësimet individuale të kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Aktgjykimit A.nr.1649/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021; Njoftimin e datës 25.10.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 03.06.2021 të Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Formularit MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar ka aplikuar në konkursin e shpallur me datë 12.07.2019 dhe i mbyllur me datë 19.07.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit", është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe rregullores Nr.21/2012 për Avancim të Karrierë të Nëpunësve Civil pasi që kandidatja e përzgjedhur nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës minimumi pesë (5) vite si dhe kandidatja e përzgjedhur ende është në periudhë provuese në shërbimin civil meqenëse e njëjta në shërbimin civil është përzgjedhur sipas njoftimit të datës 10.05.2019.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që vendimi i Sekretari të Përgjithshëm i datës 02.09.2019 me ref: 02/Nr.246 dhe numër protokoli:214 për transferimin e ankueses nga pozita "Zyrtare për Politika Turistike" në Departamentin e Turizmit në pozitën "Zyrtare e Arkivit" në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme e ka nxjerrë si masë të presionit pasi që Sekretari i Përgjithshëm i kishte kërkuar paraprakisht të tërhiqej nga konkursi si dhe mos të bëjë ankesë për procedurat e rekrutimit, po ashtu edhe vërejtja e datës 04.09.2019 e shqiptuar nga Ushtruesi i Detyrës i Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme për mos respektim të orarit të punës është në të njëjtin qëndrim me Sekretarin e Përgjithshëm ngase posedoj raportet e mjekut dhe kërkesën me shkrim për pushim mjekësor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se në konkursin e brendshëm të datës 12.07.2019 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit", të shpallur sipas autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP të datës 12.07.2019 kriteret e konkursit kanë qenë: *Fakulteti Turizmit, Ekonomik apo Shkenca Shqërore si dhe Minimum 5 vite përvojë pune profesionale*, ndërsa kandidatja e përzgjedhur znj. _____ në dosje posedon Diplomën me numër Nr.195/0217 të datës 28.02.2017 të lëshuar nga Kolegji Fama me të cilën dëshmohet se me datë 04.11.2016 ka mbaruar studimet në programin Menaxhment dhe ka marrë titullin "Bachelor i Arteve në Menaxhment" po ashtu në bazë provave të lëndës e njëjta posedon akt emërimit e datës 17.06.2019 me të cilën dëshmohet se e njëjta është emëruar në shërbimin civil në pozitën "asistente ekzekutive" në kohëzgjatje: pa afat - e karrierës nga data 17.06.2019, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se e njëjta kandidate nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pesë (5) vjet profesionale pas diplomimit, mbi bazë të kësaj Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së saj në listën e shkurtër respektivisht përzgjedhjes ka vepruar në kundërshtim

me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: përvoja e punës"* dhe nenit 13 paragrafit 1 dhe 2, nën paragrafit 2.7 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Drejton dhe mbikëqyrë një divizion në kuadër të departamentit, Karakteristikat e nivelit drejtues dy (2) janë, Diplomë universitare dhe së paku pesë (5) vite përvojë pune"*.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se kandidatja e përzgjedhur bazuar në Akt Emërimin e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është emëruar në shërbimin civil nga data 17.06.2019, rrjedhimisht kandidatja e përzgjedhur në shërbimin civil ka përvojë punë vetëm një (1) muaj dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi për Shërbimin Civil ende është në periudhë provuese siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafit 1 cili parasheh se: *"Të gjithë kandidatët që pranohen në Shërbimin Civil në pozitë të karrierës emërohen në punë provues me kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) muaj. Në përfundim të periudhës së punës provuese, eprori i drejtpërdrejtë në bazë të vlerësimit pozitiv të performancës, mbështetur në rezultatet në punë të nëpunësit civil, vendos konfirmimin ose jo të tij në atë pozitë pune"*, po ashtu e njëjta nuk posedon dy (2) vlerësime të rezultateve në punë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe nuk i ka plotësuar kriteret e kohës minimale të qëndrimit në gradën përkatëse para avancimit siç është e përcaktuar me Rregulloren Nr.21/2021 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 si dhe neni 10 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Avancimi në karrierë bëhet në baza konkurruese: avancimi në karrierë në Shërbimin Civil bëhet në mënyrë transparente, të drejtë të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës", "kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara me këtë Rregullore", "Koha minimale për avancim në karrierë nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mire, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm"*, andaj mbi këtë bazë dhe asaj që u theksua më lartë, Kolegji ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit" është zhvilluar në kundërshtim me nenin 27 paragrafin 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se: *"avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale"*, si dhe nenit 2 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: *"Gradimi është i mundur vetëm për nëpunësit civilë të karrierës, të cilët janë të klasifikuar jo me poshtë se dy (2) gradë të punës nga pozita e shpallur e lirë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj"*, pasi që e kandidatja e përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e paparapara me dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar, ndërsa procedura e rekrutimit për pozitën në fjalë duhet të anulohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në bazë të vendimit të datës 02.09.2019 me numër Ref:02/Nr.246 dhe numër Protkoll:2141 ankuesen e ka transferuar nga pozita "Zyrtare për Politika Turistike" në Departamentin e Turizmit në pozitën "Zyrtare e Arkivit" në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, po ashtu në përmbajtjen e vendimit për transfer nuk është dhënë asnjë arsytim se cili ka qenë shkaku i transferimit, baza ligjore dhe as afatin kohor se për çfarë periudhe kohore do të zgjatë transferi, andaj me këtë rast Sekretari i Përgjithshëm ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit

Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 28 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *"Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ri caktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë"* dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil neni 4 paragrafin 2 dhe neni 6 ku përcaktohet se: *"Transferimi i përkohshëm mund të zgjatë deri dymbëdhjetë (12) ditë"*, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar pasi që vendimi i Sekretari të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 02.09.2019 me numër Ref:02/Nr.246 dhe numër Protkoll:2141 është nxjerrë në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe paragrafin 2, ku përcaktohet se: *"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që Ushtruesi i Detyrës i Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme nëpërmjet e-mailit të datës 04.09.2019 ora 08:53 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje", për mos respektim të orarit të punës edhe pse ankuesja nëpërmjet e-mailit të datës 04.09.2019 në orën 08:06 minuta paraprakisht e ka njoftuar se nga sot hyj në pushim mjekësor, si rrjedhojë pushimi mjekësor për nëpunësit civil është e drejtë e garantuar me dispozitat ligjore në fuqi të legjislacionit për shërbimin civil siç përcaktohet me neni 40 paragrafin 1 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushim mjekësor"* dhe neni 9 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, për më tepër ankuesja pushimin mjekësor e ka dëshmuar edhe me raporte mjekësore të datës 02.09.2019; 03.09.2019; 04.09.2019 siç përcaktohet me neni 9 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *"Ai duhet të sigurojë për udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë një vërtetim nga organi kompetent mjekësor"*, rrjedhimisht masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses është vendosur në kundërshtim me 63 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: *"nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj"* si dhe Rregulloren Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, pasi që ankuesja në rastin konkret nuk ka shkelur detyrat e punës por ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, kështu që pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me datë 03.07.2021 ka pranuar përgjigjen përmes e-maili në kërkesën e Këshillit të datës 03.06.2021 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, se kandidates së përzgjedhur në konkursin e kontestuar për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit" i është lëshuar Akt Emërimi, kurse ankuesja me akt emërim mbanë pozitën "Zyrtare për Politika Turistike" dhe nga data 20.01.2021 me vendim zëvendëson pozitën e Drejtorit të Departamentit të Turizmit, ndërsa në dosjen e saj nuk ka asnjë masë disiplinore, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka vendosur për pretendimet ankimore lidhur me procedurën e rekrutimit, ndërsa sa i përket vendimit për transfer dhe masës disiplinore Kolegji vetëm ka konstatuar gjendjen faktike dha bazën juridike

ndërsa nuk ka vendosur pasi që vlerëson se objekti i shqyrtimit është i pamundur dhe si i tillë nuk ekziston më sa i përket transferimit dhe masës disiplinore të shqiptuara ndaj ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 2147 të datës 03.09.2019 me rastin e trajtimit të ankesës së datës 28.08.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.377/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Sekretarit të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

